

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: IL-26-2610-1-1-1

Sa i përket tenderit për : Furnizim me Gypa dhe Fazoneri - RITENDER

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Adetex Sh.p.k

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Muharrem Fejza P.n

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

+383 48142559

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)

AGIM FEKA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Adetex.ks@gmail.com

(Adresa elektronike)

06.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe viza)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Publikimi i njoftimit për kontratë :

22.04.2026 Data e dorëzimit të tenderit :

03.06.2026

Data dhe ora e fillimit të procesit për hapjen e tenderëve: 03.06.2026 / 14:00h

Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët

Njoftimi për vendimin e AK : 10.06.2026

Data e Kërkesës së parë për rishqyrtim : 14.06.2026

Vendim për aprovimin e kërkesës për RISHQYRTIM\_ Adetex SH.P.K..pdf :

16.06.2026

Njoftimi për vendimin e AK- RIVLERËSIM : 26.06.2026

Data e Kërkesës së dytë për rishqyrtim : 27.06.2026

Vendim për refuzimin e kërkesës për RISHQYRTIM\_ Adetex SH.P.K..pdf :

29.06.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

NUK KEMI MARR PJESE NE HAPJEN E TENDERIT

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

## **6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.*

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, pas aprovimit të kërkesës së parë për rishqyrtim të datës 16.06.2026, perseri AK ka shpallur fitues të njejtin OE, pasi kemi dorëzuar kërkesën e dytë për rishqyrtim me datë 27.06.2026. Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 29.06.2026, duke mos e dhënë asnjë arsyetim konkret dhe të bazuar se përse pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

## **7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmblylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

- Nenin 7 të LPP-së,
- Nenin 51 të LPP-së,
- Nenin 52 të LPP-së,
- Nenin 59 të LPP-së,
- Nenin 60 të LPP-së,
- Nenin 69 të LPP-së,

**Shkeljet e REGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar janë:**

- Neni 25 Kriteret e përzgjedhjes të RrPP-së
- Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës të RrPP-së
- Neni 38 Sqarimi i Tenderëve të RrPP-së
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të RrPP-së

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Te pa kenaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues : Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A. me nr.prokurimit : IL-26-2610-1-1-1 me titull : Furnizim me Gypa dhe Fazoneri – RITENDER te dates : 26.06.2026

Në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, paraqesim këtë Kërkesë për Rishqyrtim kundër vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë të tjerë (LURN Sh.p.k dhe XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k )

### SHKELJA E KRITEREVE TË DOSJES SË TENDERIT NGA OPERATORËT E TJERË EKONOMIKË

#### a) Gjetjet Për operatorin ekonomik **LURN Sh.p.k**

#### **I. Mospërbushja e kërkesës së Dosjes së Tenderit për garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi**

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet themelore të prokurimit publik, duke e konsideruar si të përgjegjshme ofertën e operatorit ekonomik **Lurn ShPK**, ndonëse ky operator nuk e ka përbushur një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Në Dosjen e Tenderit, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale neni 9.1&9.2, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht:

- **“ Operatori Ekonomik duhet te ofroj autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për gypa “**
- **"Garancionin nga furnizuesi për produktet e ofruara, minimum 24 muaj nga data e liferimit."**

Ndërsa si: Dëshmi e kërkuar dokumentare :

**“Autorizim i nënshkruar dhe vulosur nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për gypa”**

**"Garancioni i nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi."**

Në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorin ekonomik **Lurn ShPK** rezulton se është paraqitur vetëm dokumenti **"Warranty Declaration"**, i lëshuar, nënshkruar dhe vulosur nga kompania **Kuzyboru A.Ş.**, e cila është **prodhuesi i gypave**, dhe

mbulon vetëm gypat poliester dhe lidhëset nga poliester.

Në paramasën e paraqitur përveç gypave të poliester janë kërkuar edhe shumë materiale pjesë fazonale nga materiali i gizës të cilat nuk i mbulon me prodhim kjo fabrikë e gypave nga poliester **Kuzyboru A.Ş.** si përshembull:

**Pjesë Fazonale nga materiali i gizës :**

\* **MMA-KS (ONP-PN) Ø 250 / 125 ( Ø 280 / 125)**

\* **Kokë hidrantit tip të prodhuesit "LIV" Varazhdin Ø 125**

\* **Kokë hidrantit tip të prodhuesit "MTZ" Shkup Ø 124**

\* **GS ( Zhibo lidhëse) lidhëse**

\* **SOP me dimensione të ndryshme**

\* **OZ ( valvula Ovale me diamter të mëdhej nga DN 125 deri DN 400 ) etj.**

Dhe plotë materiale të tjera nga giza në kuadër të fazonerisë, të cilat janë specifikisht të kërkuara në paramasë.

- Autoriteti Kontraktues gjatë pregaditjes së paramasës dhe kërkesave në FDT e ka pas të kurtë që materialet e kërkuara në paramasë prodhohen nga prodhues të ndryshëm, me të drejtë ka kërkuar : **"Garancionin nga furnizuesi për produktet e ofruara, minimum 24 muaj nga data e liferimit"**, dhe në këtë rast **Operatori Ekonomik (OE )** që ka

pregaditë ofertën është **FURNIZUESI**, dhe është kërkuar që Furnizuesi (OE) të mbulojë me deklaratë Garancioni 24 Muaj të gjitha materialet e ofruara- kërkuara Vetë Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka bërë dallim të qartë ndërmjet termave **"prodhues"**, **"distributor i autorizuar"** dhe **"furnizues"**. Për autorizimin ka kërkuar dokument nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, për detajin teknik ka kërkuar dokument të nënshkruar nga prodhuesi, ndërsa për garancionin ka kërkuar shprehimisht dokument të nënshkruar dhe vulosur nga **furnizuesi**. Kjo dëshmon se Autoriteti Kontraktues ka përdorur këto terma me vetëdije dhe me kuptime të ndryshme juridike, andaj ato nuk mund të interpretohen si sinonime gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Kërkesa për garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi nuk është vendosur pa arsye, por ka për qëllim përcaktimin e qartë të subjektit kontraktues OE që mban përgjegjësinë ndaj Autoritetit Kontraktues (AK) gjatë gjithë periudhës së garancionit, sepse AK ka të drejtë të kekojë përgjegjësi në baz të ligjeve të Kosovës vetëm nga Operatori Ekonomik me të cilin lidhë kontratën për t'i furnizuar të gjitha materialet e kërkuara.

Në rast të ndonjë defekti, mosfunksionimi, zëvendësimi të produktit ose nevojës për ndërhyrje gjatë periudhës së garancionit, Autoriteti Kontraktues nuk ka marrëdhënie kontraktuale me prodhuesin, por ekskluzivisht me operatorin ekonomik fitues, respektivisht furnizuesin që nënshkruan kontratën. Pikërisht për këtë arsye, Dosja e Tenderit ka kërkuar garancion nga furnizuesi dhe jo nga prodhuesi.

Po të kishte qenë qëllimi i Autoritetit Kontraktues që garancioni të lëshohej nga prodhuesi, kjo do të ishte specifikuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, ashtu siç është bërë për autorizimin dhe për dokumentet e tjera teknike. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në mënyrë të qartë **garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi**, ndërsa operatori ekonomik Lurn ShPK nuk e ka dorëzuar këtë dokument

|  |   |
|--|---|
| Garancioni nga furnizuesi për produktet e ofruara, minimum 24 muaj nga data e liferimit.   | Garancioni i nenshkruar dhe furnizuesi.   |
| Vërtetimi i detalit të lidhjes së gypit të azbestcementit dhe gypit të poliesterit të jetë i vërtetuar nga prodhuesi – detali është pjesë e dosjes së tenderit si aneks. | Detali i lidhjes se gypit azbestcent te poliesterit te jete i nenshkrua nga prodhuesi |

Prandaj nga ana Autoriteti Kontraktues pranimi i një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi si zëvendësim i dokumentit të kërkuar nga furnizuesi përbën ndryshim të përmbajtjes së kriterit pas hapjes së ofertave dhe një interpretim të zgjeruar të kërkesave të Dosjes së Tenderit, gjë që bie ndesh me **nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili garanton trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë, si dhe me **nenin 59 të LPP-së**, sipas të cilit Autoriteti Kontraktues është i detyruar të vlerësojë ofertat vetëm mbi bazën e kriterëve dhe kërkesave të publikuara në Dosjen e Tenderit, pa i ndryshuar ose relativizuar ato gjatë procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, operatori ekonomik **Lurn ShPK** nuk e ka përmbushur një kërkesë substanciale dhe të detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Mosdorëzimi i garancionit të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi e bën ofertën e tij të papërgjegjshme dhe, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe me vetë kërkesat e Dosjes së Tenderit, ajo është dashur të refuzohet.

#### I. Lista e kontratave dhe referencave

Pas analizimit të ofertës së operatorit ekonomik të cilin AK e ka shpallur fitues, rezulton se **OE LURN Sh.p.k** nuk ka dëshmuar përvojën e kërkuar për furnizime të natyrës së ngjashme.

Në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar qartë: "Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit". Gjithashtu është kërkuar që OE të paraqes: • listën e furnizimeve të kryera; shumën e kontratës; datën; pranuesin; referenca ose çertifikata të pranimit për furnizimet e realizuara. Megjithatë, OE i shpallur fitues nuk ka paraqitur referenca për furnizime, por ka paraqitur referenca që kanë të bëjnë me kryerje të punimeve dhe mbi të gjitha as edhe një nga këto punë të realizuara nuk i përket natyrës së aktivitetit të këtij prokurimi. Realizimi i Punimeve dhe furnizimet janë kategori të ndryshme të kontratave publike dhe nuk mund të konsiderohen assesi të barasvlershme. Objekti i këtij aktiviteti është: "Furnizim me Gypa dhe Fazoneri" dhe jo realizim të punimeve ndërtimore dhe instalimeve elektrike. Prandaj, referencat për punime: nuk dëshmojnë kapacitetin furnizues; nuk dëshmojnë përvojë në furnizim të produkteve të kërkuara; nuk dëshmojnë realizimin e kontratave të ngjashme me natyrën (objektin) e prokurimit.

a) **Gjetjet per operatorin ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k**

I. Mospërbushja e kërkesës së Dosjes së Tenderit për garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi nga operatori ekonomik XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimet themelore të prokurimit publik, duke e konsideruar si të përgjegjshme ofertën e operatorit ekonomik **XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.**, ndonëse ky operator nuk e ka përbushur një kërkesë të detyrueshme të Dosjes së Tenderit.

Në Dosjen e Tenderit, te kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht:

**"Garancionin nga furnizuesi për produktet e ofruara, minimum 24 muaj nga data e liferimit."**

Ndërsa si dëshmi është kërkuar:

**"Garancioni i nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi."**

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik **XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.** rezulton se është paraqitur vetëm një deklaratë garancioni (**Warranty Statement**) e lëshuar, nënshkruar dhe vulosur nga kompania **Poliester Cevi d.o.o.**, e cila është prodhuesi i mallrave, ndërsa nuk është dorëzuar garancioni i nënshkruar dhe vulosur nga vetë furnizuesi, respektivisht operatori ekonomik **XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.**

Për më tepër, ndryshe nga dokumentacioni i operatorëve të tjerë, deklarata e garancionit e prodhuesit **Poliester Cevi d.o.o.** nuk identifikon fare aktivitetin e prokurimit për të cilin pretendohet se është lëshuar. Në këtë dokument nuk figuron as **titulli i aktivitetit të prokurimit "Furnizim me Gypa dhe Fazoneri – RITENDER"** dhe as **numri i prokurimit IL-26-2610-1-1-1**, por dokumenti i referohet vetëm një **Quotation No. 238-1/2026**, pa e lidhur garancionin me aktivitetin konkret të prokurimit. Për pasojë, ky dokument nuk dëshmon në mënyrë të qartë dhe të pakontestueshme se është lëshuar pikërisht për këtë procedurë të prokurimit.

Vetë Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit, ka bërë dallim të qartë ndërmjet termave **"prodhues"**, **"distributor i autorizuar"** dhe **"furnizues"**. Për autorizimin ka kërkuar dokument nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, për detajin teknik ka kërkuar dokument të nënshkruar nga prodhuesi, ndërsa për garancionin ka kërkuar shprehimisht dokument të nënshkruar dhe vulosur nga **furnizuesi**. Kjo dëshmon se Autoriteti Kontraktues ka përdorur këto terma me vetëdije dhe me kuptime të ndryshme juridike, andaj ato nuk mund të interpretohen si sinonime gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Kërkesa për garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi nuk është vendosur pa arsye, por ka për qëllim përcaktimin e qartë të subjektit kontraktues

që mban përgjegjësi ndaj Autoritetit Kontraktues gjatë gjithë periudhës së garancionit. Në këtë aktivitet të prokurimit janë kërkuar lloje të ndryshme materialesh dhe produkte nga prodhues të ndryshëm, prandaj garancioni i një prodhuesi nuk mund të zëvendësojë garancionin e furnizuesit, i cili, përmes deklaratës së tij, merr përgjegjësi kontraktuale për të gjitha produktet e ofruara në kuadër të këtij aktiviteti të prokurimit.

Në rast të ndonjë defekti, mosfunksionimi, zëvendësimi të produktit apo nevojës për ndërhyrje gjatë periudhës së garancionit, Autoriteti Kontraktues ka marrëdhënie kontraktuale ekskluzivisht me operatorin ekonomik fitues, respektivisht furnizuesin që nënshkruan kontratën, dhe jo me prodhuesin. Pikërisht për këtë arsye, Dosja e Tenderit ka kërkuar garancion nga furnizuesi dhe jo nga prodhuesi.

Po të kishte qenë qëllimi i Autoritetit Kontraktues që garancioni të lëshohej nga prodhuesi, kjo do të ishte specifikuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit, ashtu siç është bërë për autorizimin dhe dokumentet e tjera teknike. Mirëpo, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar në mënyrë të qartë **garancion të nënshkruar dhe vulosur nga furnizuesi**, ndërsa operatori ekonomik **XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.** nuk e ka dorëzuar këtë dokument.

II. Deklarata nën Betim nuk është plotësuar në përputhje me formularin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit

Operatori ekonomik **XËRXA HIDRO GROUP Sh.p.k.** nuk e ka plotësuar Deklaratën nën Betim në përputhje me formularin standard të përcaktuar në Aneksin 2 të Dosjes së Tenderit.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se formulari nuk është plotësuar në tërësi, pasi rubrika "**I përfaqësuar nga:**" është lënë e paplotësuar, ndonëse kjo rubrikë është pjesë përbërëse e formularit standard të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Numri i Prokurimit: IL-26-2610-1-1-1 – Titulli: *Furnizim me Gypa dhe Fazoneri - RITENDER*

## **Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *[operatorin ekonomik që paraqitet]* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92

Nga kjo shihet që nuk është plotësuar kriteri administrativ.

III. Mospërmbushja e kërkesës lidhur me deklaratën bankare për kapacitetin financiar

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit duke e konsideruar si të përmbushur kriterin për kapacitetin financiar, ndonëse dokumenti bankar i paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush përmbajtjen dhe

qëllimin e kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht:

**"Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhironlogari ose qasje të pakushtëzuar në kredi, dokumenti të jetë origjinal, i drejtuar për Autoritetin Kontraktues, me emër të projektit, numër të prokurimit, i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar."**

Megjithëse dokumenti bankar është i drejtuar për Autoritetin Kontraktues dhe përmban emrin e projektit dhe numrin e prokurimit, ai vetëm konfirmon gjendjen e llogarisë bankare në datën 01.06.2026 dhe shumën e mjeteve që ndodheshin në atë moment në llogarinë e peratorit ekonomik.

Në asnjë pjesë të këtij dokumenti banka nuk deklaron se këto mjete financiare janë të dedikuara, të rezervuara apo të disponueshme për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit, respektivisht për ekzekutimin e kontratës në rast të shpërblimit me kontratë. Gjithashtu, banka nuk merr asnjë obligim se operatori ekonomik do të ketë në dispozicion këto mjete për realizimin e këtij projekti.

Qëllimi i këtij kriteri nuk është vetëm evidentimi i gjendjes momentale të llogarisë bankare, por sigurimi i Autoritetit Kontraktues se operatori ekonomik disponon kapacitetin financiar të nevojshëm për realizimin e kontratës objekt të këtij aktiviteti të prokurimit. Një konfirmim i thjeshtë i gjendjes së llogarisë në një datë të caktuar nuk garanton se të njëjtat mjete do të jenë të disponueshme për realizimin e kontratës.

Me këtë veprim janë shkelur:

- Neni 7 i LPP-së (Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi);
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve);
- Neni 60 i LPP-së (Tenderi i përgjegjshëm).
- Neni 65 i LPP-së (Kriteret e Përzgjedhjes)
- Neni 69 i LPP-së – Aftësia Teknike dhe Profesionale
- Neni 72 i LPP-së – Sqarimi i Tenderëve

## II. TRAJTIMI I PABARABARTË I OPERATORËVE EKONOMIKË

**Autoriteti Kontraktues ka eliminuar operatorin ekonomik ADETEX Sh.p.k për dokumente të cilat janë dorëzuar në ofertë, ndërsa njëkohësisht ka pranuar dokumente të operatorëve të tjerë ekonomikë që nuk korrespondojnë me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.**

Ky veprim cenon drejtpërdrejt parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe transparencën e procedurës së prokurimit publik.

Prandaj, duke u bazuar në ato që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që sipas 18/18 dispozitave ligjore të Ligjit nr. 04/L- 042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, të nxjerr:

#### **VENDIM**

1. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE “Adetex SHPK,” – Prishtinë .
2. Te **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së si dhe në mbështetje të kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë të cilat vet i ka vendosur AK për këtë aktivitet të prokurimit.

### **9. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Duke marrë për bazë të gjitha resurset njerëzore të angazhuar dhe pjesa teknike e logjistike dëmet materiale të cilat do të shkaktohen janë rreth 4200 Euro**

### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*